

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve D. P. dhe A. D. që të dy nga Gjakova, që të dy veç e veç për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP. nr.265/2016, të datës 26.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 17.03.2017, në prezencën e Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj, të dëmtuarit të mitur G. D. dhe përfaqësueses së tij ligjore nënës L. D. si dhe të akuzuarve, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.D. P. nga i ati V., e ëma A., e gjinisë D., i lindur me datën..., në qytetin e G., Republika e Gjermanisë, tani me vendbanim në Gjakovë, i pa martuar, student i fakultetit Juridik në Universitetit AAB në Gjakovë, punon në autolarjen si biznes familjar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

2.A. D., nga i ati B., e ëma F., e gjinisë Z., i lindur me datën ... në Gjakovë, , i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes dobët ekonomike, përfitues i ndihmës sociale, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

1. I akuzuari D. P.

I. Sepse me datën 04.03.2016 në ora 20:10 minuta në Gjakovë, respektivisht në rrugën “M.” tek dyqani “B. Sh.” gjer sa ka qenë duke e ngasur automjetin e tipit “WV-1 KM”, me targa të regjistrimit... ngjyrë e zezë në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të komunikacionit rrugor nga pakujdesia duke mos iu përshtatur kushteve të rrugës dhe shpejtësisë së lëvizjes ku papritmas me pjesën e parë ballore të anës së djathtë e godet biçikletën të cilën ishte duke e ngasur A. D. i cili në atë moment ishte duke e kaluar rrugën nga shiriti i djathtë në atë në të majtë të rrugës ndërsa si rezultat i goditjes biçiklisti dhe bashkudhëtari i tij femiu –G. D. që gjendej në pjesën e pasme të biçikletës përplasen për tokë, ku nga ky aksident shkaktohen dëme materiale në automjet dhe biçikletë ndërsa lëndime të lehta trupore pësojnë ngasësi i biçikletës A. D. dhe bashkudhëtari i tij – fëmija G. D., sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjor të datës 04.08.2016 e Dr. M. H. G..

Me këto veprime ka kryer vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

2. I akuzuari A. D.

II. Sepse me datën, kohën e vend të njëjtë sikurse në pikën e parë të këtij dispozitivi të këtij aktgjykimi gjer sa ka qenë duke e ngasur biçikletën e tipit “Scot San Francisco”, në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të komunikacionit rrugorë nga pakujdesia duke mos iu përshtatur kushteve të rrugës dhe shpejtësisë së lëvizjes ku papritmas pa u siguruar mirë kthehet majtas duke mos e vlerësuar si duhet shpejtësinë e lëvizjes së veturës “VW Golf 5” me të cilën përball kalonte edhe e cila veturë e kishte të drejtën e përparësisë së kalimit ku me ç ‘rast godet

nga vetura "Golf 5", rezultat i goditjes ngasësi i biçikletës- i akuzuari dhe bashkudhëtari i tij femiu i tij G. D. përplasen për toke, ku nga ky aksident shkaktohen dëme materiale në automjet dhe biçikletë, ndërsa lëndime të lehta trupore përveç ngasësit të biçikletës pëson edhe bashkudhëtari i tij femija- G. D., sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjorë të datës 04.08.2016 e Dr. M. H. G.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 43, 46, 73, dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarin D. P., për veprën penale nën. I të dispozitivit e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300 (treqind) Euro të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 Euro.

I dëmtuari G. D. nga Gjakova, për realizimin e kërkesës pronësore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari D. P., që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88 Euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20 Euro si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 23, 77, 78 par.1 nënpar.1.1 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarin A. D., për veprën penale nën. II të dispozitivit e:

L I R O N N G A D Ë N I M I

Për shkak se pasojat e veprës penale e godasin kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

I akuzuari A. D., lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat bijën në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.nr. 265/2016, të datës 26.05.2016, kundër të akuzuarve D. P. dhe A. D. që të dy nga Gjakova, ku fillimisht të njëjtit i ka akuzuar për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.7 lidhur me par.6 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, ka bërë rikualifikimin e veprës penale duke deklaruar se meqenëse gjatë leximit të aktakuzës vërejtja se në të dy dispozitivet është dhënë kualifikim juridik nga neni 378 par.7 lidhur me par.6 të KPRK-së, e që nga dispozitivi i aktakuzës konsiderohej se nuk përkon ky kualifikim ngase vlera e dëmit nuk është mbi 15.000 Euro, për të cilat nuk kemi edhe shënime nga provat që i janë bashkangjitur shkresave të lëndës andaj, bëjë rikualifikimin e veprës penale ashtu që vepra penale për të cilën akuzohen këtu të akuzuarit D. P. dhe A. D. duhet të jetë vepra penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar. Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës dhe rikualifikuar të bërë, kundër të akuzuarve D. P. dhe A. D. andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të

dënohet sipas ligjit.

I akuzuari D. P., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar për këtë veprim, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar për rastin e ndodhur, i vjen keq për atë çka ka ndodhur dhe ka shtuar se dëmtuarit i kam ndihmuar që të kurohet për lëndimet e marra andaj i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla do të jem më i kujdesshëm.

I akuzuari A. D., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar për këtë veprim, në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe ka shtuar se nuk kam dashur që të ndodh pasi që në këtë aksident vet kam pësuar lëndime të lehta po ashtu edhe djali i im, të cilat më kanë goditur rënd.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, duke e dhënë mendimin rreth pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që pranimin e fajësisë e kanë bërë me vetëdije dhe vullnet të plotë, pra presion, të njëjtit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë mbështet edhe në faktet dhe provat që janë bashkangjitur aktakuzës.

Përfaqësuesja ligjore e palës së dëmtuar G. D., nëna e tij L. D., duke e dhënë mendimin rreth pranimit të fajësisë nga të akuzuarve ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë, por si palë e dëmtuar nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, pasi që të akuzuarin A. D. e kam bashkëshort përkatësisht i dëmtuari G. e ka baba, por edhe sa i përket të akuzuarit D. P. nuk i bashkëngjitem ndjekës penale pasi që i njëjti pas kryerjes së veprës penale është përkujdesur për lëndimet që ka pësuar djali ynë, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike ka deklaruar se parashtron kërkesë pasurore-juridike.

I dëmtuari i mitur G. D., duke e dhënë mendimin rreth pranimit të fajësisë nga të akuzuarve ka deklaruar se: në tërësi pajtohet me theksimet e nënës së tij L. D., nuk çka të shtojë tjetër.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I. Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D. P. me datën 04.03.2016 në ora 20:10 minuta në Gjakovë, respektivisht në rrugën “Migjeni” tek dyqani “Baby Shop” gjer sa ka qenë duke e ngasur automjetin e tipit “WV-1 KM”, me targa të regjistrimit... ngjyrë e zezë në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të komunikacionit rrugor nga pakujdesia duke mos iu përshtatur kushteve të rrugës dhe shpejtësisë së lëvizjes ku papritmas me pjesën e parë ballore të anës së djathtë e godet biçikletën të cilën ishte duke e ngasur A. D. i cili në atë moment ishte duke e kaluar rrugën nga shiriti i djathtë në atë në të majtë të rrugës ndërsa si rezultat i goditjes biçiklisti dhe bashkudhëtari i tij femiu-G. D. që gjendej në pjesën e pasme të biçikletës përplasen për tokë, ku nga ky aksident shkaktohen dëme materiale në automjet dhe biçikletë ndërsa lëndime të lehta trupore pësojnë ngasësi i biçikletës A. D. dhe bashkudhëtari i tij – fëmija G. D., sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjor të datës 04.08.2016 e Dr. M. H. G..

II. Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. D. me datën, kohën e vend të njëjtit sikurse në pikën e parë të këtij dispozitivi të këtij aktgjykimi gjer sa ka qenë duke e ngasur biçikletën e tipit “Scot San Francisco”, në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të komunikacionit rrugorë nga pakujdesia duke mos iu përshtatur kushteve të rrugës dhe shpejtësisë së lëvizjes ku papritmas pa u siguruar mirë kthehet majtas duke mos e vlerësuar si duhet shpejtësinë e lëvizjes së veturës “VW Golf 5” me të cilën përball kalonte edhe e cila veturë e kishte të drejtën e përparësisë së kalimit ku me ç ‘rast godet nga vetura “Golf 5”, rezultat i goditjes ngasësi i biçikletës- i akuzuari dhe bashkudhëtari i tij fëmija i tij G. D. përplasen për toke, ku nga ky aksident shkaktohen dëme materiale në automjet dhe biçikletë, ndërsa lëndime të lehta trupore përveç ngasësit të biçikletës

pëson edhe bashkudhëtari i tij fëmija- G. D., sipas mendimit të ekspertit mjeko-ligjorë të datës 04.08.2016 e Dr. M. H. G..

Gjykata gjendjet e këtilla faktike i ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë të paraparë me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të gjykojnë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit D. P. gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është student, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij duke i kërkuar falje palës së dëmtuar dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale do të jetë më i kujdesshëm, më parë nuk ka qenë i dënuar, si dhe faktin se pas kryerjes së veprës penale i ka ndihmuar të dëmtuarit G. D. për lëndimet e marra të kurohet. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së dhe se dënimi i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Me rastin e vendosjes lidhur me vendimin mbi dënimin ndaj të akuzuarit A. D., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat, kështu që duke u mbështetur në nenin 78 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, gjykata ka gjetur se ekzistojnë bazat e posaçme të lirimit nga dënimi për veprën penale të kryer nga pakujdesia pasi që pasojat e veprës penale aq rëndë e kanë goditur kryerësin sa që nuk ka kuptim të dënohet nga aspekti humanitar duke pasur kujdes për personin i cili edhe pse me fajin e tij, aq rëndë ka pësuar nga vepra penale, ashtu që vuajtjet e tija personale e tejkalon rëndësinë e dënimit, prandaj dënimi si e tillë paraqitet si i panevojshëm sepse në rastin konkret si rezultat i veprës penale lëndime të lehta trupor ka pësuar vet i akuzuari si dhe djali i tij këtu i dëmtuari i mitur G. D.. Se me të vërtet vepra penale e ka goditur aq shumë të akuzuarin gjykata e vërtetoj edhe nga fakti se i akuzuari gjatë tërë shqyrtimit fillestar ka qenë emocionalisht i prekur thellë. Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh edhe për preventivën e përgjithshme dhe se vepra penale është kryer nga pakujdesia, prandaj është ardhur në përfundim se dënimi paraqitet si i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.1 lidhur me par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi lirimin e të akuzuarit A. D. nga shpenzimet e procedurës është marrë

konform nenit 453 par.4 të KPP-së, për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohet gjendja materiale e të akuzuarit për faktin se i njëjti është përfitues i ndihmës sociale, ku i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar, gjykatës ia ka dorëzuar një kopje të librezës që vërteton se i njëjti është përfitues i ndihmës sociale.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr. 491/16, me datë 17.03.2017

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.